



Aneks 22a

SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K

Adresa: Rruga "Dibres" Pall.324/1 Tirane
Email: lireng.auditing@gmail.com
Tel/Fax: +355 42 450 952
Mob: 0672079155

Raporti i Audituesit

**Asamblese se Pergjithshme:
Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar**

Tirane, Rruga Muhamet Gjollesha, Sheshi Mustafa Q. Ataturku, ish 21 Dhjetori

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur te "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar" (OJF), Tirane te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e ardhurave dhe shpenzimeve gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit te mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, të marra në tërësi dhe në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 "Për shpalljen e detyrueshme të tyre", pozicionin financiar te "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar" (OJF), Tirane, me 31 Dhjetor 2016 dhe performancën financiare dhe të fluksit monetar për periudhën kontabël të mbyllur në këtë datë, të përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Bazat për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standartet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-te). Përgjegjësitë e tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar" (OJF ne perputhje me kerkesat etike qe jane te zbatueshme per auditimin e pasyrave financiare ne Republiken e Shqiperise, dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'u përdorur si baze ne dhënien e opinionit tone të audituesit.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë e të drejtë në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe për ato kontrole të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e (OJF) për të vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë (OJF) ose të ndërpresë aktivitetin, ose nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të (OJF).

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Firma : Neshat MAZE
Ekspert i Kontabël i Rregjistruar



Tirane, Mars 2017

Shtojcë e Raportit të Audituesit.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-te, në ushtrime gjykimin profesional dhe ruajme skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Në gjithashtu:

- Identifikojme dhe vleresojme rreziqet e anomalise materiale, qofte për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojme dhe kryejme procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vleresojmë përshtatshmerinë e politikave kontabel të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabel dhe të shpjegimeve përkatëse të bërë nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmerinë e përdorimit të bazës kontabel të vijmesisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse në arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri në duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të përshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarja ose kushtet të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërprejë veprimtarinë.
- Në komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Firma : Neshat MAZEA
Ekspert Kontabel i Rregjistruar



Tirane, Mars 2017

Anex 22a/3

PASQYRA E GJENDJES SE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Emertimi		Viti 2016	Viti 2015
A	GJENDJA		
	SHUMA	28,417,874	20,666,032
		28,417,874	20,666,032

PASQYRA E KRIJIMIT TE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Nr	Emertimi	Viti 2016	Viti 2015
B	TE ARDHURAT		
		54,517,593	58,165,714
I	Fonde nga Entitete te Huaja	42,448,959	50,635,058
	Te ardhurat nga Komiteti Olimpik Nderkombetar e		
1	SO	26,616,204	22,829,747
2	Te ardhurat nga Komiteti Olimpik European	13,504,145	14,795,437
3	Te ardhura nga Kom. Organizator Lojrave Europiane		11,657,677
4	Te ardhurat nga ICMG	1,773,038	1,352,197
5	Te ardhurat nga ANOC	394,240	
6	Te ardhurat per Lojrat Islamike	161,331	
	Fonde te Sponsorizuar nga Entitete Brenda		
II	Vendit	4,068,634	2,031,656
1	Te ardhurat nga sponsorizime vendas	3,500,000	-
2	Te ardhurat nga anetaresimet	228,600	93,000
3	Te ardhura te tjera (Kurse Admin, kurs Kembimi)	340,034	1,938,656
III	Fonde te Akorduar nga Buxheti I Shtetit	8,000,000	5,499,000
	TOTALI	54,517,593	58,165,714

PASQYRA E PERDORIMIT TE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Nr	Emertimi	Viti 2016	Viti 2015
C	SHPENZIMET		
I	Perdorimi I Fondeve te Huaja per:	45,912,955	44,914,872
1	Bursa Olimpike	4,996,091	5,623,141
2	Mobilje Paisje dhe Mjete te tjera Inventari	652,761	1,490,793
3	Shpenzime per akomodim dhe dieta	4,734,807	6,190,035
4	Shpenzime transporti	9,125,295	7,958,752
5	Shpenzime per materiale	517,809	1,886,819
6	Shpenzime postare dhe telefonike	762,517	818,663
7	Shpenzime karburanti	325,922	268,991
8	Shpenzime per energji elektrike	189,046	266,672
9	Shpenzime per qira	123,834	267,400
10	Shpenzime per mirembajtje	507,924	360,664
11	Shpenzime per honorare (përfshirë tatimi)	4,020,947	3,281,235
12	Shpenzime per paga, sigurime, tatime	2,112,710	1,909,539
13	Shpenzime Publikimi dhe Promovimi	2,790,271	2,110,738
14	Shpenzime te tjera	2,823,466	4,808,280
15	Mbeshtetje financiare per Federatat	12,229,556	7,673,150
	<i>Perdorim i Fondeve te Huaja sipas Vendimeve te Komitetit Ekzekutiv Akorduar:</i>	<i>12,229,556</i>	
1	Federata Shqiptare e Atletikes (Luiza Gega)	62,978	
2	Federata Shqiptare e Basketbollit	1,005,161	
3	Federata Shqiptare e Çiklizmit	1,923,101	
4	Federata Shqiptare e Gjinnastikes	172,164	

5	Federata Shqiptare e Hendbollit	27,360		
6	Federata Shqiptare e Notit	761,807		
7	Federata Shqiptare e Qitjes	913,374		
8	Federata Shqiptare e Xhudos	564,400		
9	Shoqata Shqiptare e Harkut	915,637		
10	Komiteti Olimpik Rajonal Elbasan	60,000		
11	Federata Shqiptare e Alpinizmit	300,000		
12	Federata Shqiptare e Aeronautikes	200,000		
13	Federata Shqiptare e Badmintonit	130,000		
14	Federata Shqiptare e Bilardos	300,000		
15	Federata Shqiptare e Karatese	151,790		
16	Federata Shqiptare e Ping - Pongut	270,600		
17	Federata Shqiptare e Rafting	199,444		
18	Federata Shqiptare e Skive	437,030		
19	Federata Shqiptare e Taekwondo	299,710		
20	Federata Shqiptare e Volejbollit	3,395,000		
21	Shoqata e Edukimit Fizik dhe Sportit Shkollor	40,000		
22	Mbeshetje financiare per fatkeqesi	100,000		
	Perdorimi I Fondeve te Sponsorizuara nga			
II	Entitete Brenda Vendit		2,899,043	
1	Shpenzime per materiale		1,025,677	
2	Shpenzime per honorare (përfshirë tatimi)		50,000	
3	Shpenzime per akomodim dhe dieta		13,440	
4	Shpenzime Publikimi dhe Promovimi		1,332,750	
5	Shpenzime te tjera		477,176	
	Perdorimi I Fondeve te Akarduar nga Buxheti			
III	Shtetit per:		6,541,118	4,666,267
1	Paga dhe Sigurime		3,913,027	4,167,267
2	Fond I alokuar per Komitetin Olimpik Special			499,000
	Fond i alokuar per Federatat per Loj. Olimp. "Rio 2016"		1,994,229	
3				
4	Federates Shqiptare te Boksit	800,000		
5	Federates Shqiptare te Notit	794,229		
6	Federates Shqiptare te Peshengritjes	400,000		
7	Lojrat Olimpik "Rio 2016"		633,862	
	TOTALI		55,353,116	49,581,139

PASQYRA E KTHIMIT TE FONDEVE NE BUXHETIN E SHTETIT NGA KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Nr	Emertimi	Viti 2016	Viti 2015
D	KTHYER NE BUXHET	1,458,882	832,733
	SHUMA	1,458,882	832,733

PASQYRA E GJENDJES SE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Nr	Emertimi	Viti 2016	Viti 2015
E	GJENDJA	26,123,469	28,417,874
	TOTALI(A+B-C-D)	26,123,469	28,417,874

Shoqeria Audituese "MIRENG Auditing" Shpk

Eksperit Kontabël i Rregjistruar

Nesha MAZE

